

V E N D I M
Nr.430, datë 25.3.1996

**PËR RREGULLIMIN E KOHËS SË PUNËS E TË PUSHIMIT NË NDËRMARRJET QË
SIGUROJNË FURNIZIMIN ME BUKË DHE TË MIRA MATERIALE QË DËMTOHEN
SHPEJT**

Në zbatim të ligjit nr.7961, datë 12.7.1993 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë e Ushqimit dhe të Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Në furrat e bukës, punishtet e pastave dhe bonboneritë kohëzgjatja javore maksimale e punës është 50 orë.

Nëse puna e së dielës ka një kohështirje nga mëngjesi deri në pasdrekë apo zgjat mbi 3 orë, punëdhënësi duhet ta kompensojë në javën pasardhëse me një pushim jo më pak se 24 orë, i cili duhet të korrespondojë me një ditë pune.

2. Në shitoret e mishit kohëzgjatja javore maksimale e punës është 50 orë.

Në dimër punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë fillimin e punës në orën 500.

3. Në punishtet e përpunimit të qumështit dhe të nënprodukteve të tij puna nuk mund të fillojë para orës 300 ose të zgjatë pas orës 2400

Punëdhënësi mund të urdhërojë punëmarrësit të punojnë të dielën, nëse një gjë e tillë është e nevojshme për të parandaluar dëmtimin e mallit.

Ai ka të drejtë veçanërisht të urdhërojë punën të dielën për:

a) të sjellë qumështin dhe nënproduktet e tij pranë popullsisë;

b) të transportuar qumështin nga qendra e prodhimit dhe stacionet hekurudhore në depot e lokalet e shitjes;

c) të marrë në dorëzim qumështin për ta filtruar e freskuar;

d) të përpunuar qumështin deri në orën 1300 maksimumi;

e) të shitur produktet e bulmetit.

Puna të dielën duhet të reduktohet në atë më të domosdoshmen.

4. Në tregtinë e fruta-perimeve kohëzgjatja javore maksimale e punës mund të zgjatet maksimumi 6 orë, me kusht që të mos kapërcehet si mesatare vjetore.

Punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë fillimin e punës në orën 400 dhe mbarimin e saj në orën 2200 maksimumi.

Në rast nevoje, dhe vetëm gjatë periudhës prill-tetor, punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë kryerjen e punës natën.

Ai ka të drejtë gjithashtu të urdhërojë të punuarit përkohësisht të dielave, kur një gjë e tillë bëhet e domosdoshme për të mënjanuar dëmtimin e mallit.

5. Në gjithë sektorët e mësipërm puna duhet të ndërpritet nga pushime minimumi:

a) 15 minuta, nëse dita e punës zgjat më shumë se 5 orë e 30 minuta;

b) 30 minuta, nëse dita e punës zgjat më shumë se 7 orë dhe

c) 60 minuta, nëse dita e punës zgjat më shumë se 9 orë.

Pushimet llogariten si kohë pune, në rastin kur punëmarrësi nuk është i autorizuar të largohet nga vendi i punës gjatë këtyre pushimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi